



Fondo europeo per l'integrazione di cittadini di paesi terzi

Akordi I Integrit

Akordi është një instrument për të lehtësuar integrimin e qytetarit të huaji (duke filluar nga mosha 16 vjeç) i cili hyn për herë të parë në Itali dhe prezanton një kërkesë për lëshimin e lejes së qëndrimit (permesso di soggiorno) për një periudhë jo më pak se një vit. Brënda dy viteve të para, i huaji duhet të arrijë një total prej 30 kredish për të mund të rinovuar lejen e qëndrimit (permesso di soggiorno).

Me nënshkrimin e akordit i huaji përfiton 16 kredi dhe gjatë vlefshmërisë së lejes së parë të qëndrimit (permesso di soggiorno) angazhohet të:

- ndjek brënda tre muajve nga nënshkrimi i Akordit, seksionin e trajnimit prej 10 orësh (kursi i edukatës qytetare) i organizuar në Qendrat Territoriale të Përhershme. Mos pjesëmarrja sjellë humjen e 15 kredive
- garantoji arsimimin e detyrueshëm të fëmijëve të mitur
- paguaji taksat dhe kontributet

Për të përmbushur Akordin është e nevojshme të arrihen 30 kredi, qytetari i huaji mund:

- të arrijë një nivel të duhur të njohjes së gjuhës italiane, jo më të ulët se niveli A2 të Tabelës së Përbashkët Europiane të Referimit për Gjuhët (30 kredi)
- Të ndjekë titullin e studimit të ciklit të parë të arsimit i organizuar nga Institucionet Arsimore (30 kredi)
- të zgjedhi mjekun e familjes (libreza shëndetsore) (4 kredi)
- të nënshkruajë një kontratë qeraje (6 kredi)
- të ushtrojë një veprimtari sipërmarrese

Kredit mund të humben në rastin e:

- mos pjesëmarrjes brënda tre muajve nga nënshkrimi i akordit, në seksionin e trajnimit (kursi i edukatës qytetare) i organizuar në Qendrat Territoriale të Përhershme
- dënimeve penale edhe jo definitive (numri i kredive të hequra ndryshon në vartësi të kohëzgjatjes së dënimit) për shembull, shkelje administrative, masa sigurie etj.

Në mbarimin e afatit prej dy vitesh, Sporteli Unik verifikon gradën e integrit të arritur duke ftuar të huajin të prezantojë dokumentacionin e duhur (titujt e studimit, dëshmi të ndjekjes së shkollës nga fëmijët (dëftesa), certifikatat e pjesëmarrjes në kurse, libreza shëndetsore, etj.) për njohjen e kredive shtesë.

Kredi midis 1 dhe 29

Në rastin kur i huaji nuk ka arritur një numër të mjaftueshëm të kredive është parashikuar një shtyrje e akordit prej një viti. Në këtë rast i huaji duhet të prezantojë një kërkesë në Sportelin Unik për Emigracionin.

Kredi baraz me 0

I hiqet leja e qëndrimit (permesso di soggiorno) dhe dëbohet nga territori nacional

Per informacione të mëtejshme

www.immigrazione.regione.toscana.it > Accordo di integrazione (Akordi i Integrit)

Kontakte

Telefon: 055 2783643 (nga e hëna në të enjte 9.00 - 13.00)

E-mail: immigrazione.pref_firenze@interno.it